



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË



Nr. 2596 prot., datë 24.04.2026

Nr. 1368 prot., datë 24.04.2026

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**MINISTRISË SË DREJTËSISË**

**DHE**

**ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

*“Për Harmonizimin, Zbatimin dhe Publikimin e të Dhënave Statistikore Kombëtare të Sistemit të Drejtësisë”*

Sot më datë, 24, 04, 2026, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet palëve:

**MINISTRA E DREJTËSISË** me adresë: Bulevardi “Zogu I”, përfaqësuar nga Ministri i Drejtësisë **z. Toni Gogu**, këtu e në vijim “Ministria”,

dhe

**ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**, me adresë: Sheshi Nënë Tereza, Godina nr. 13, Tiranë , përfaqësuar nga Inspektori i Lartë, **z. Artur Metani**, këtu e në vijim “Inspektori i Lartë i Drejtësisë”.

Duke vlerësuar rëndësinë e statistikave kombëtare të sistemit të drejtësisë si një instrument themelor për garantimin e transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimin e performancës së sistemit të drejtësisë, si dhe duke marrë në konsideratë nevojën për

unifikimin e treguesve kryesorë të performancës me qëllim rritjen e transparencës dhe forcimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, me synim harmonizimin e metodologjisë së mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave statistikore me standardet e Komisionit Evropian për Eficencën e Drejtësisë (CEPEJ), në kuadër të procesit të integritimit evropian zbatimit të Agjendës Kombëtare të Reformave, ratifikuar me ligjin nr. 19/2025 “Për ratifikimin e marrëveshjes së facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga komisioni, për rregullimet specifike për zbatimin e mbështetjes së Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të facilitetit për reforma dhe rritje” dhe publikimit të Vjetarit Statistikor.

Palët nënshkruese bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi për Harmonizimin, Zbatimin dhe Publikimin e të Dhënave Statistikore Kombëtare të Sistemit të Drejtësisë, e cila synon të krijojë kuadrin për bashkëpunimin ndërinstitucional dhe të rregullojë proceset e mbledhjes, përpunimit, raportimit dhe publikimit të të dhënave statistikore të sistemit të drejtësisë, në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian për Eficencën e Drejtësisë (CEPEJ) dhe legjisllacionin kombëtar në fuqi.

#### Neni 1 **Objekti**

Objekti i kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i kuadrit të bashkëpunimit ndërinstitucional për harmonizimin dhe standardizimin e metodologjisë, si dhe për rregullimin e proceseve të mbledhjes, përpunimit, shkëmbimit, raportimit dhe publikimit të të dhënave statistikore në sistemin e drejtësisë.

#### Neni 2 **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje mbështetet në:

1. Nenet 102, pika 4, dhe 147/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
2. Nenin 5, pika 3 dhe nenin 6 pika 15, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar;
3. Nenin 170, pika 5 dhe nenin 204, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

#### Neni 3 **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të sigurojë rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe aksesin në statistikat e sistemit të drejtësisë, përmirësimin e performancës së tij, si dhe forcimin e besimit të publikut, nëpërmjet përpunimit, raportimit dhe publikimit të të dhënave statistikore të sakta, të krahasueshme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, përfshirë metodologjinë e CEPEJ.

#### Neni 4 **Parimet e Bashkëpunimit**

Palët angazhohen të bashkëpunojnë në zbatim të kësaj marrëveshjeje mbi bazën e parimeve të:

- Ligjshmërisë* – zbatimi i kësaj marrëveshjeje në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Transparencës* – sigurimi i aksesit të publikut në të dhënat statistikore, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës;
- Saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave* – garantimi i cilësisë së të dhënave statistikore përmes përdorimit të metodologjive të standardizuara;
- Koordinimit ndërinstitutional* – bashkërendimi i veprimeve dhe shkëmbimi i rregullt i informacionit ndërmjet palëve;
- Standardizimit* – përdorimi i treguesve dhe metodologjive të unifikuara, në përputhje me standardet e CEPEJ;
- Përgjegjshmërisë* – respektimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë marrëveshje nga secila palë;

#### Neni 5 **Detyrimet e palëve**

Institucionet nënshkruese të kësaj marrëveshjeje marrin përsipër këto detyrime:

1. Të sigurojnë harmonizimin e proceseve të mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave statistikore, në përputhje të plotë me Udhëzimin nr. 2, datë 26.06.2025, të Ministrit të Drejtësisë, si dhe me metodologjinë e CEPEJ.
2. Të garantojnë raportimin e të dhënave statistikore brenda afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 26.06.2025.
3. Të publikojnë të dhënat statistikore vjetore sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 2, datë 26.06.2025 (ankesat e shqyrtuara dhe raste kryesisht, hetimet, kërkesat për hetim disiplinor dhe inspektimet tematike dhe institucionale).
4. Të caktojnë strukturat përkatëse ose personat përgjegjës për koordinimin dhe zbatimin efektiv të kësaj marrëveshjeje.
5. Të sigurojnë raportimin periodik mbi ecurinë e zbatimit të kësaj marrëveshjeje, si dhe të identifikojnë dhe adresojnë në kohë problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të saj.
6. Të trajtojnë si konfidencial çdo informacion të dhënë për nga natyra dhe përmbajtja, pa cenuar detyrimet që lidhen me veprimtarinë profesionale dhe çdo detyrim tjetër ligjor.
7. Të mos përdorin informacionin për qëllime të tjera nga ato të parashikuara në këtë Marrëveshje.

#### Neni 6 **Personat e kontaktit dhe komunikimi ndërmjet palëve**

1. Palët caktojnë një ose më shumë persona kontakti nga stafi i tyre, të cilët janë përgjegjës për sigurimin e komunikimit të vazhdueshëm dhe efektiv ndërmjet palëve, për shkëmbimin e të dhënave, si dhe për koordinimin dhe ndjekjen e veprimtarive të nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Për qëllime të këtij neni, pikat e kontakti janë:

Për Ministrinë e Drejtësisë  
Saimir Topuzi

Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë  
Leonora Jata

Specialist në Sektorin e Monitorimit, Jetësimin  
të Prioriteteve dhe Statistikave

Përgjegjës në Sektorin e Analizës,  
Monitorimit të Rekomandimeve të  
Inspektimit

Email:saimir.topuzi@drejtesia.gov.al

Email: leonora.jata@ild.al

2. Komunikimi ndërmjet palëve kryhet në formë zyrtare shkresore ose nëpërmjet komunikimit elektronik (e-mail), duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

3. Palët njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën për çdo ndryshim të personit të kontaktit dhe të të dhënave të tyre përkatëse.

#### Neni 7

#### **Mospërputhjet në interpretim**

Çdo mospërputhje në interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi do të zgjidhet në mënyrë miqësore përmes konsultimeve të drejtpërdrejta ndërmjet palëve.

#### Neni 8

#### **Kohëzgjatja**

Kjo marrëveshjeje do të jetë në fuqi deri në krijimin dhe funksionimin e plotë të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve. Deri në këtë moment, mbledhja dhe plotësimi i formularëve me të dhënat statistikore kombëtare të sistemit të drejtësisë do të realizohen në format Excel, në përputhje me formularët e Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr. 2, datë 26.06.2025.

#### Neni 9

#### **Dispozita e fundit**

1. Palët janë të detyruara të respektojnë këtë marrëveshjeje për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në nenin 8 të saj.
2. Kjo marrëveshjeje nuk përbën burim të krijimit të detyrimeve monetare apo financiare ndërmjet palëve.
3. Çdo shtesë apo ndryshim i kësaj marrëveshjeje bëhet vetëm me marrëveshjeje me shkrim ndërmjet palëve.

4. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe publikohet në faqet zyrtare të institucioneve nënshkruese.

Sa më sipër, përfaqësuesit e të dy palëve nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë juridike.

**PËR  
MINISTRINË E DREJTËSISË**

**MINISTRI**

**Toni Gogu**



**PËR  
ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË  
TË DREJTËSISË**

**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

**Artur Metani**

